



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 5659/1
Prot

Tiranë, më 21/7/2021

URDHËR

Nr. 134, Datë 21.7.2021

**“PËR NDRYSHIMIN E REFERENCËS LIGJORE NË STANDARDET
KOMBËTARE TË KONTABILITETIT TË PËRMIRËSUARA”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të referencës ligjore në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.
2. Ndryshimi i referencës ligjore në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara e shtrin efektin që në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në datën 1 Janar 2019.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTËR

Anila Denaj

